

Burri i mirë

Hoxhë Lulzim Perçuku

Vëllezër myslimanë!

Allahu thotë: **“Jetoni e silluni mirë me to!”** Nisa, 19. Kjo është porosi dhe urdhër prej Allahut. Myslimani është i obliguar që ta kalojë jetën mirë me gruan e tij. Kjo sjellje duhet të jetë ajo që është më e mira, duke përfshirë fjalë dhe veprat. Kështu, kur burri i drejtohet gruas, t’i drejtohet me fjalë të mira, me shprehje të bukura e të buta, jo me vrazhdësi dhe arrogancë. Gjithashtu, me veprime të mira e jo me ashpërsi.

Gruaja, nga natyra e saj është e dobët. Allahu e ka krijuar të tillë. Burri është më i fuqishëm sesa ajo. Por, shumë prej burrave këtë fuqi që kanë e shfrytëzojnë dhe i sulmojnë ato, apo u bëjnë padrejtësi atyre. Islami e ka ndaluar këtë padrejtësi dhe e ka urdhëruar burrin të sillet me butësi e me bamirësi ndaj saj dhe me çdo gjë që është e mirë.

Jeta me gratë duhet të jetë e pozitës së ngritur, e bazuar në vepra të mira, në bamirësi, në raporte të mira reciproke, në vlerësim reciprok etj.

Allahu thotë: **“Nëse ju i përmirësoni marrëdhëniet dhe ruheni nga padrejtësia, ta dini se Allahu është vërtet Falës dhe Mëshirëplotë.”** Nisa, 129. Përmbyllja me faljen dhe mëshirën e këtij ajeti në të cilin Allahu flet për raportin që duhet të jetë mes bashkëshortore, është argument se ai i cili kujdeset që në raportin dhe sjelljen ndaj gruas të jetë i drejtë dhe korrekt, ai e meriton faljen dhe mëshirën e Allahut.

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem thotë: **“Ju porosis që të silleni mirë me gratë e juaja!”** do të thotë duhet të silleni mirë me to me të gjitha fjalët dhe veprat e juaja, vazhdimisht ta këshilloni porositni njëri-tjetrin për t’u sjellë mirë me gratë, duke qenë ky një lloj amaneti i përhershëm ndaj njëri-tjetrit (pas vdekjes së Pejgamberit) deri Ditën e Gjykimit. Ky urdhër vlen edhe më shumë në rastin kur personi e di se një burrë nuk sillet mirë me gruan e tij dhe shkon për ta këshilluar dhe porositur që të sillet mirë ngase kështu na ka porositur Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem. Nëse ne e zbatojmë këtë urdhër, edhe jeta jonë bashkëshortore do përmirësohet (e nuk do të vazhdojnë brengat, shqetësimet, mosprehja në martesë etj.).

Nëse burri do të ketë një jetë të kënaqur, të ndershme, fisnike e të respektueshme me gruan e tij, atëherë nuk duhet që mangësitë e neglizhencat e saj të mundohet t’i përmirësojë me ashpërsi e arrogancë. Gabimet e lëshimet e gruas duhet t’i përmirësojë me butësi, pa nxitim në fjalë e në veprime, jo me ashpërsi e arrogancë, ngase përndryshe nuk do të ketë jetë të rehatshme e të mirë.

Qëllimi nuk është që burri ta lejojë gruan të veprojë çfarë do ajo, si: mëkate, haramet etj. Mirëpo, sa herë që prej saj vije ndonjë gabim apo lëshim, ai duhet të mundohet ta përmirësojë dhe shërojë atë me butësi, nëse do të ketë jetë të mirë me gruan e tij. Burri i mirë i cili i përmbahet Islamit në shtëpinë e tij, ia jep ato të drejta të cilat Islami ia ka dhënë asaj dhe e ndalon atë nga haramet. Burri e ka vënë atë nën përgjegjësinë e vet dhe e ka obligim që ta ndalojë nga ndalesat e Allahut të Lartësuar. Mirëpo, ai nuk e godet, nuk e rrahë, nuk e shan dhe nuk e fyen.

Nëse burri do që gruaja e tij të jetë e atillë ashtu siç ai do, në çdo gjë, pa mangësi, atëherë le ta dijë se do ta thyejë atë (gruan) dhe nuk do ta arrijë këtë që kërkon. Burri duhet t'i përballojë disa lëshime, mangësi, gabime dhe sjellje jo të mira që i vijnë nga ajo.

Nëse burri vazhdon me ashpërsi e arrogancë duke u munduar ta përmirësojë (drejtojë) gruan e tij, atëherë do të përfundojë në divorc. Shumë prej burrave të tillë që janë të ngutshëm përfundojnë kështu. Shumë prej tyre, fjala apo mendimi i parë që u shkon ndërmend është divorci, edhe në rastet më të vogla e të parëndësishme. Ka prej tyre që nuk i pëlqen si gatuan gruaja, apo si e mban shtëpinë, rrobat dhe veten e saj, andaj dhe e divorcon. Këto gjëra njeriu duhet të mundohet t'i përmirësojë me durim e mosnxitim, hap pas hapi për një kohë të gjatë. Nëse përpiqet ta përmirësojë menjëherë atë dhe të jetë ashtu siç ai do, atëherë do vije deri te divorci, ose më së paku, nuk do të ketë jetë të rehatshme e të qetë bashkëshortore.

Besimtari nuk duhet që ta shfrytëzojë fuqinë, pozitën dhe autoritetin e tij si burrë, nga ana tjetër dobësinë e gruas së tij, e kështu ta godasë dhe ta rrahë atë. E pastaj kur vije nata ai fle me të dhe i afrohet asaj. Kjo është kontradiktore me jetën e mirë bashkëshortore dhe qetësinë mes besimtarit dhe besimtares. Ashpërsinë, arrogancën dhe këtë mënyrë të sjelljes me gratë e ka ndaluar Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem. Nëse Allahu të ka dhënë fuqi fizike dhe pastaj e përdor atë ndaj gruas tënde, atëherë kujtoja vetes se Allahu është më i fortë sesa ti dhe mund të të ndëshkojë për këtë sjellje. Ajo që të ndihmon të mos veprosh kështu, është përkujtimi i vetes se edhe ti ke motër e vajzë. Si do ta prisje lajmin nëse ndokush do të tregonte se në këtë mënyrë është sjell me motrën tënde burri i saj apo me vajzën tënde burri i saj? Pa dyshim se do ndjeje dhimbje shpirtërore.

O vëllezër të nderuar!

Profeti salAllahu alejhi ue selem thotë: **"Të mos e urrejë besimtari besimtaren, nëse nuk pëlqen prej saj një moral, do t'i pëlqejë një moral tjetër."** Muslimi. Ky hadith e qetëson besimtarin dhe ia rehaton shpirtin në jetën e tij bashkëshortore. E shumë bashkëshortë do qetësoheshin prej problemeve nëse do e zbatonin këtë hadith. Jeta bashkëshortore dhe urrejtja (mospëlqimi) nuk shkojnë bashkë. Gjëja që e ndihmon njeriun të mos e urrejë gruan e tij është: **"...nëse nuk pëlqen prej saj një moral, do t'i pëlqejë një moral tjetër."** Me këtë Profeti salAllahu alejhi ue selem po na sjell një peshore që është e mirë dhe e bukur. Ai na mëson se burri nuk duhet që vazhdimisht të shikojë në gabimet dhe lëshimet e gruas, duke i kujtuar dhe duke e pasur mendjen në to. Nëse vepron kështu, patjetër rezultati do jetë urrejtja e mospëlqimi ndaj gruas së tij.

Nëse vjen ndonjë gabim e lëshim nga gruaja e jote, menjëherë duhet t'ia kujtosh vetes sjelljet e tjera të mira që ajo ka ndaj teje. Thuaj: “Ajo bëri vërtetë këtë gabim, mirëpo ka vepruar (dhe vepron) shumë gjëra (sjellje) të tjera të mira ndaj meje.” Nëse i numëron të mirat dhe anët pozitive të saj, kështu do e largosh mospëlqimin dhe urrejtjen ndaj një sjelljeje të keqe që ajo e ka vepruar ndaj teje. Duhet ditur se edhe këtu djalli ka vend. Ai vije dhe ia kujton njeriut të këqijat, lëshimet e gabimet e gruas së tij derisa burri fillon të urrejë apo të mos e pëlqejë atë dhe të ftohet ndaj saj, sa i përket dashurisë dhe lidhjes që kanë mes vete burrë e grua. Kurrë në jetë nuk do arrish që ajo të jetë ashtu siç do ti, por duhet që gjithnjë t'ia kujtosh vetës të mirat e saj ndaj teje, duke mos menduar vetëm të këqijat.

Edhe në fund të jetës së tij, Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka porositur për sjellje të mirë ndaj bashkëshorteve ngase ato janë nën kujdesin e burrave të tyre. Kjo e ndihmon njeriun ta përmirësojë raportin dhe sjelljen me gruan e tij. Ai le ta kujtojë se ajo ka dal nga shtëpia e babait pasi ka qenë nën kujdesin dhe udhëheqjen e tij, e pastaj ka ardhur në shtëpinë tënde duke u vënë nën kujdesin dhe udhëheqjen tënde. Ti je ai që tash e urdhëron atë e nuk vepron pa urdhrat e tu. Andaj, ajo është e dobët dhe qëndron nën kujdesin e udhëheqjen tënde dhe duhet t'i kushtosh kujdes dhe sjellje të mirë asaj, ngase ka dal nga shtëpia e saj në të cilën e ka nderuar dhe respektuar prindi, vëllai etj., kështu në të njëjtën mënyrë duhet të sillësh edhe ti ndaj saj, me nderim e respekt.

Nëse gruaja nuk i bindet burrit në atë që ai e urdhëron, nuk duhet që ai menjëherë të sillet me të me ashpërsi dhe arrogancë. Nëse ajo flet fjalë jo të mira ndaj tij, nuk i bindet urdhrat të tij, nuk e respekton, vepron vepra që ai nuk i pëlqen, ka sjellje të këqija ndaj tij, e mallkon, e ofendon, e lëndon etj., atëherë gjëja e parë që bën është ta këshillojë atë, t'ia përkujtojë Allahun, dënimin e Tij, duke i thënë: “Të kesh frikë Allahun, sjellja jote nuk është sjellje islame” etj. Nëse kjo nuk i bën dobi, atëherë ai largohet prej shtetit të saj (e bojkoton në shtrat). Kjo nuk do të thotë që ai të dalë nga shtëpia e të flejë diku tjetër duke u shfaqur te njerëzit me fjalët: “Nuk i kam raportet mirë me grua, andaj e kam bojkotuar.” Ky veprim duhet të jetë çështje e brendshme, mes tij e gruas së tij, e jo ta marrin vesh të tjerët, ajo realizohet brenda në shtëpi (ai një shtrat e ajo një shtrat). Nëse nuk përmirësohet, atëherë ai mund ta rrahë, por kjo rrahje nuk duhet të lë shenja në trup (e assesi ta godasë në fytyrë), as të jetë rrahje e ashpër duke ia thyer ndonjë kockë apo t'i dalë gjak, e as të jetë rrahje me të cilën ai e shfaq mllefin dhe i bën padrejtësi asaj. Mirëpo, duhet të jetë goditje për ta edukuar atë. Rrahja është faza e fundit. Nëse gruaja përmirësohet dhe kthehet te sjellja e mirë ndaj burrit dhe te zbatimi i urdhrave të tij, nuk duhet që burri të sillet ashpër pastaj ndaj saj, por duhet të sillet me butësi dhe mirësi.

Atë ushqim që e ha ti, me atë duhet ta ushqesh edhe gruan tënde, e jo ti të hash mirë e asah t'i japësh ushqim të dobët. Me atë vlerë (cilësi) të rrobave që e vesh veten tënde, duhet ta veshësh edhe gruan tënde. Nëse je i pasur, atëherë nuk duhet që vetë të vishesh mirë e gruas t'i dhurosh veshje të vjetër.

Allahu thotë: **“...në qoftë se është i varfër, le të harxhojë aq sa është e arsyeshme dhe e drejtë.”** Nisa, 6. E nëse burri është i varfër, nuk duhet të thotë: “Jam i varfër, andaj nuk duhet të shpenzoj për familjen.”

Goditja e gruas në fytyrën e saj është e ndaluar dhe haram. Fytyra është pjesë e lartësuar e njeriut. Ajo përfshin shqisa të ndjeshme. Nëse e godet në të, mund t'ia dëmtosh syrin apo t'ia humbasësh dëgjimin. Goditja në fytyrë është poshtërim dhe nënçmim i madh. Nuk lejohet që bashkëshortes tënde t'ia bësh këtë poshtërim e nënçmim, edhe nëse dëgjon fjalë shqetësuese dhe të papëlqyera prej saj.

Burri i mirë nuk duhet t'i flasë gruas fjalë me të cilat e nënçmon atë, si: ti je e shëmtuar, Allahu të shëmtotfë, familja jote është e keqe, je grua e ulët, nuk ke vlerë, etj. Këtë e ka ndaluar Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem. Myslimani e ka obligim të flasë vetëm fjalë të mira, edhe në rastet e hidhërimit e zemërimit ai duhet ta ruajë gjuhën nga fjalët e këqija.

Vëllai dashur!

A do që ta dish se a e ke arritur besimin e plotë? Shiko se çfarë sjellje dhe morali ke. Besimtari me besimin më të plotë është ai që e ka sjelljen dhe moralin më të mirë. E më të mirët janë ata që e kanë sjelljen dhe moralin më të mirë me bashkëshortet e tyre. I tilli e ka besimin më të lartë.

Shumë prej burrave kanë sjellje dhe moral të mirë me të tjerët (me shokët etj.), flasin me fjalë të zgjedhura duke mos i lënduar, ndërsa kur janë në shtëpitë e tyre kanë sjellje të keqe, e ngrehin zërin, flasin fjalë të ashpra (me gruan e fëmijët) etj. Shtëpia është ajo e cila e zbulon moralin dhe sjelljen e njeriut. Moralin më të mirë, besimtari duhet ta tregojë brenda shtëpisë së tij, me gruan dhe fëmijët, pastaj me të tjerët jashtë shtëpisë. E kundërta nuk është prej udhëzimit të Islamit.

Nëse ndonjërit Allahu i jep një grua të mirë në fenë e saj, në sjelljet e saj, moralin e saj, në adhurimet që bën, në mendjen e logjikën e saj të shëndosh (e pjekur), vërtetë atij Allahu i ka dhënë mirësi dhe furnizim të madh. Ky është prej furnizimit më të mirë që Allahu ia jep besimtarit, sepse kur gruaja është e mençur do dijë se si ta rregullojë raportin brenda shtëpisë së saj, në mënyrën më të mirë, duke bërë kështu që burri i saj të jetojë një jetë të lumtur e të rehatshme. Pra, pjesa më e mirë e kënaqësisë së shkurtët të kësaj bote është gruaja e devotshme.

Besimtari do ta arrijë lumturinë në shtëpinë e tij nëse atë e ndërton mbi vepra të mira me të cilat është i kënaqur Allahu. Po ashtu, ai me këtë do arrijë t'i bëjë të lumtur anëtarët e familjes së tij. Burri në shtëpi, është esenca e lumturisë, pa marrë parasysh sa është i moshuar. Njashtu dhe gruaja. Sikur njerëzit t'i përmbaheshin Islamit në raportet burrë-grua, do të ishin të lumtur në shtëpitë e tyre. E kur besimtari është i lumtur dhe rehat në shtëpinë e tij, edhe raportet me të tjerët do t'i ketë të mira. E njashtu dhe adhurimi i tij do jetë ashtu siç e kërkon/do Allahu.

A ka më mirë se kur burri dhe gruaja i rregullojnë raportet e tyre në bindjen ndaj Allahut? Nuk ka më mirë sesa kur një burrë dhe një grua janë të kënaqur e të lumtur ndërmjet vete duke qenë në bindje ndaj Allahut. Në këtë rregullim të marrëdhënieve, ka rehati e qetësi të zemrës, mendjes dhe lumturi.

Burri i mirë i cili i përmbahet Islamit do të ketë një jetë të mirë. Brendësia e tij do të jetë e qetë. Burri i mirë është i mëshirshëm dhe i butë me gruan e tij. Ai nuk e ngarkon atë me atë që nuk ka mundësi. Ai

e di se gruaja ka mangësi, andaj e përgatit veten për t'i pranuar ato dhe i mbyll sytë kur ndonjëherë ndodhin gabime nga ajo. Ai nuk e merr gruan e tij në llogari për çdo gjë. Ajo nuk është në gjendje të veprojë çdo gjë, andaj dhe nuk mund të japë llogari për çdo gjë.

Burri i mirë, nëse urren një sjellje prej gruas së tij, e largon atë duke e ditur se ka gjëra të tjera që i do tek ajo. Allahu thotë: **“Jetoni e silluni mirë me to! Në qoftë se ato nuk ju pëlqejnë aq shumë, (duronit!) sepse është e mundur që juve të mos ju pëlqejë diçka, por që Allahu në atë do t’ju sjellë shumë të mira.”** Nisa, 19. Profeti salAllahu alejhi ue selem thotë: **“Të mos e urrejë besimtari besimtaren, nëse nuk pëlqen prej saj një moral, do t’i pëlqejë një moral tjetër.”** Muslimi. Andaj, nuk të lejohet që për një sjellje të keqe të saj, ta braktisësh e ta urresh, ngase ka shumë të mira të tjera që të bëjnë ta duash atë.

Burri vepërmirë e di se gruaja është e dobët dhe se atë e ka marrë me amanet prej Allahut, andaj nuk i bën padrejtësi asaj. Ai nuk ia përhap të metat dhe fshehtësitë që ka mes tij dhe gruas, edhe nëse është caktim të ndahen (pas ndarjes) përsëri e ka të ndaluar t’i shfaqë ato.

Burri i mirë argëtohet me gruan e tij dhe e bën të buzëqeshë. Ai bën veprime të cilat e afrojnë me të. Me këtë e rrit dashurinë mes tyre. Krejt kjo duke e pasuar sunetin. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka garuar në vrapim me Aishen radijAllahu anha, edhe pse ka qenë në moshë. Po ashtu, ia ka dhënë një copë mishi që ta hajë ajo, pasi e ka kafshuar një copë, Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem e ka vënë gojën e tij mbi atë pjesë të mishit ku e ka vënë ajo.

Burri i mirë e nderon gruan e tij sepse kjo është porosia e Profetit salAllahu alejhi ue selem. Kështu e arrin lumturinë në shtëpinë e tij dhe e bën të lumtur gruan e tij. Sikur të gjithë burrat t’i përmbaheshin rregullave të Islamit në shtëpitë e tyre, atëherë të gjithë do ishin të lumtur dhe s’do ndodhnin këto probleme që po i dëgjojmë sot. Mirëpo, disa burra janë të pakujdesshëm ndaj të drejtave të grave të tyre. E si pasojë, ata janë të pakënaqur në shpirtrat dhe shtëpitë e tyre. Kjo sepse ata kanë sjellje të keqe ndaj grave, hidhërohen shumë shpejt, e Islami e mëson njeriun që të jetë i qetë dhe që problemet në bashkëshortësi të zgjidhen në mënyrën më të mirë. Kur ata dalin nga shtëpia, dalin duke qenë nervoz. E kur kthehen, janë edhe më nervoz. Në këtë mënyrë, gratë e tyre jetojnë me ta në një jetë të vështirë dhe dëshpërim të madh. Këta burra mendojnë se çdo sjellje e keqe që vjen prej grave të tyre, është shkaku tek to. E nuk mendojnë se ndoshta shkaku është tek vetë ata ngaqë kanë moral dhe sjellje të keqe ndaj grave të tyre. Të tillët, fjalët e mira i ruajnë për shokët. E ofendimet dhe ngritjen e zërit e veprojnë para grave të tyre në shtëpi. E si ka mundësi që ata ta arrijnë lumturinë në shtëpitë e tyre kur ata kanë hequr dorë nga obligimet dhe të drejtat që Islami ua ka obliguar t’i aplikojnë në shtëpitë e tyre?! Me këtë kanë mbyllur dyert e prej të cilave vije lumturia e myslimanit brenda mureve të shtëpisë së tij.

Burri i mirë i cili pretendon islamin dhe i cili dëshiron të arrijë lumturinë dhe rehatinë në shtëpinë e tij, e ka obligim t’i përmbahet Islamit dhe rregullave të cilat ia ka caktuar sa i përket sjelljes ndaj gruas dhe familjes së tij. E po ashtu le të ketë shembull Muhamedin salAllahu alejhi ue selem në këtë gjë.

Duhet ta dish se gruaja e jote i bartë fëmijët e tu, është ajo që e ruan pasurinë tënde, e cila kujdeset për sekretet e tua, andaj duhet të sillesh me modesti ndaj saj dhe gjithëherë të jesh fytyrëçelur dhe

fytyrëqeshur kur të flasësh e diskutosh me të. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem na ka mësuar se buzëqeshja ndaj vëllait tënd mysliman është sadaka, e njeriu që ka më së shumti të drejtën në këtë buzëqeshje, është gruaja jote. Buzëqeshja është ajo që i ngjall shpirtrat, fshin prej gjokseve urrejtjen dhe mllëfin që kanë njerëzit mes vete.

Myslimani duhet ta lavdërojë gruan e tij, rreth veshjes së saj, ushqimit që e përgatit, apo zbukurimit që ajo e bën për të. Nëse vepron kështu, atëherë ti e tërheq zemrën e saj. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem e ka lejuar që nganjëherë bashkëshortët edhe të gënjejnë (duke shfaqur dashurinë të madhe edhe nëse nuk është e tillë), në mënyrë që të shtohet dashuria ndaj bashkëshortëve.

Dhurata i hap zemrat (i afron ato), ashtu siç na ka mësuar Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem, ajo e shton dashurinë mes njerëzve. Dhurimi i dhuratave ndërtohet në dashurinë, gëzimin dhe lumturinë që është mes dy bashkëshortëve. Prandaj, njeriu duhet të jetë i thjeshtë ndaj gruas së tij, të sillet me thjeshtësi ndaj saj. Ai duhet t'i largojë fjalët që janë dykuptimëshe dhe mendjemadhësinë ndaj saj. Nëse e largon mendjemadhësinë, mburrjen e krenarinë përball saj dhe nuk përdor fjalë të dykuptimëshe, atëherë kjo është shenjë që tregon për një jetë të lumtur mes burrit dhe gruas.

Që të jesh bujar në të shpenzuarit dhe dhuruarit ndaj familjes tënde, është shpenzimi dhe sadakaja më e mirë. Nuk ka sadaka më të vlefshme sesa të shpenzosh nga pasuria jote për familjen tënde.

Nëse ti dëshiron që gruaja jote të jetë e udhëzuar në rrugën e Allahut, atëherë ti duhet të jesh i pari i cili drejtohet në këtë rrugë. Në të gjitha fushat e jetës, vepro ashtu siç kërkon Allahu në Kuran dhe në sunnetin e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem. Nëse ti je i tillë, atëherë ajo me lejen e Allahut do të jetë më e udhëzuar sesa ti.

Vëllai i nderuar!

Duhet ditur se nuk duhet ta lëshosh shikimin në atë që ta ka ndaluar Allahu i Madhërishëm, duke i shikuar gratë e tjera. Mëkati është një e keqe në shtëpinë tënde, i cili pastaj le pasoja të papërmirësueshme. Të shikosh TV, seriale apo emisione të ndryshme, ku ka gra të zbuluara, të cilat e zbulojnë bukurinë e tyre, kjo rezulton në pasojën se bukuria e gruas tënde nuk do peshojë në sytë e tu, nuk e sheh më si të bukur. Gjithashtu pozita e saj e lartë që ka qenë në zemrën tënde, do bie, do pakësohet. Kjo gjë është shkaktare që zemrat të përçahen, të largohen dhe dashuria fillon të pakësohet. Gjithsesi afërsia mes tyre do pakësohet. Nga kjo fillon përçarja, këtu fillon armiqësia mes burrit dhe gruas. Nuk ka gjë që të shpëton më shumë, sesa të larguarit nga këto gjëra.

Bashkëshorti i mirë duhet të sillet me gruan ashtu siç do që ajo të sillet me të, në çdo aspekt. Ibën Abbasi radijAllahu anhu ka përmendur një segment të jetës se si burri duhet të jetë ndaj bashkëshortes, ashtu siç dhe ai do donte që ajo të ishte ndaj tij, siç thamë në çdo aspekt të jetës. Ai thotë: “Unë dëshiroj t'i zbukurohem gruas time, ashtu siç kam dëshirë që ajo të më zbukurohet mua.” Pra, ti ke dëshirë që ajo të të zbukurohet ty, atëherë edhe ti zbukurohu për të.

Nëse ndonjëherë të vjen ndonjë kritikë prej gruas tënde, atëherë dëgjoje atë me vëmendje, me gjoks të hapur dhe fytyrëçelur. Këtë gjë e gjen më së miri në jetën e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem. Shpesh herë gratë e tij e kanë korrigjuar atë në mendimet e tij dhe ai nuk është zemëruar apo hidhëruar ndaj tyre.

Nga ajo që burri e ngrit lart pozitën e tij, është që i mos të marrë prej pasurisë së gruas së tij, përveçse me lejen e saj. Ai nuk guxon të marrë asgjë nga pasuria të cilën ajo e posedon, përveç nëse ajo i jep leje. Por, nga ana tjetër, ti e ke obligim të shpenzosh për të nga pasuria jote. Shpenzo për gjëra të mira, për gjëra që janë të lejuara, e të mos tregohesh koprrac.

Gruaja ka dëshirë të bisedojë me bashkëshortin e saj, të diskutojë për të gjitha çështjet e saj. Kur ajo fillon të bisedojë me ty, ti duhet ta dëgjosh me vëmendje dhe edukatë të lartë.

Burri i mirë i kryen detyrat e punët e shtëpisë. Kjo është prej shenjave të burrave besnikë. Pra, ata që kanë qenë besnikë, i kanë kryer punët e shtëpisë, e nuk ia kanë ngarkuar të gjitha gruas. Kur është pyetur Aisha radijAllahu anha: *“Çfarë bënte Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem në shtëpinë e tij?”*, ajo tha: *“Ai ka qenë njeri sikur të tjerët, ka pastruar rrobat e tij, ka mjelë delen dhe i ka shërbyer vetes së tij.”* Transmeton imam Ahmed. Pra ai salAllahu alejhi ue selem nuk ka qenë barrë për të tjerët, i ka shërbyer vetës së tij.

Mos e tepro në qëndrimin jashtë shtëpie me shokët e tu, duke lënë anash të drejtat e familjes tënde dhe fëmijëve tu, sepse familja janë më meritore për ty sesa shokët e tu.

Mos ia kujto të metat gruas tënde që i ka bërë në të kaluarën! Mos e qorto atë duke bërë me shenja apo gjeste, duke ia shfaqur gabimet apo të metat e kaluara.

Problemet mes bashkëshortëve duhet të fshehën prej fëmijëve. Ato nuk duhen të shfaqen para tyre, sepse nëse ndodh kjo, ka pasoja të këqija në të edukuarit e tyre. Gjithashtu, do humbet edhe respekti i fëmijëve ndaj tyre si prindër.

Zemërimi dhe hidhërimi është themeli i çdo armiqësie dhe ndasie. Ndaj lidhja mes teje dhe gruas tënde është shumë më e lartë sesa ti ta poshtërosh atë në një çast hidhërimi e zemërimi që të kaplon. Andaj, burri gjithmonë duhet t'i japë prioritet heshtjes ndaj fjalëve të këqija që dalin si pasojë e hidhërimit dhe zemërimit, falja ndaj gjynaheve dhe gabimeve është më afër mendjes dhe devotshmërisë sesa të veprohet e kundërta. Umeri radijAllahu anhu ka thënë: *“Dobësinë e tyre shërojeni duke heshtur.”* Gratë janë të dobëta, prej tyre dalin gabime e lëshime, e këtë dobësi thotë shërojeni duke heshtur, duke mbyll sytë, veshët dhe duke mos i marr afër zemrës. Nëse vjen diçka që nuk u pëlqen juve, heshtni, mos ia përmendni të metat. Mos i ulni ato duke i nënshtruar dhe nënçmuar përmes gabimeve të kaluara.

Njeriu e arrin lumturinë nëse e kupton realitetin e kësaj bote dhe vlerën e ahiretit. Kjo botë është e shkurtër, ikë shpejt. Ahireti është i përherëshëm. Ai që nuk ka qenë rob i kësaj dynjaje, ai e ka arritur lumturinë në të. Ai që e ka synim ahiretin, ai ka arritur t'i veprojë shkaqet që e bëjnë të lumtur në këtë botë dhe në ahiret.

Shkëputur nga ligjëratat:

“Hadithi: “Ju porosis që të silleni mirë me bashkëshortet”,

“Si ta arrijmë lumturinë në Islam?”

“Sekretet bashkëshortore”.

Transkriptoi dhe redaktoi:

Albiona Olluri

Maj, 2016